



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 194, Datë 18.09.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SH.A. PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, 10, pikat 1 dhe 3, dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.09.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1598/2 prot., datë 13.09.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1588/1 prot., datë 04.09.2024, paraqiti kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo me vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 274 Seria T15/T20, është 05.03.2025).

- Sa konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj në datën 04.09.2024, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar, konstatohet se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.
- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 06.03.2025.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI